

Përgjegjësia Sociale e Korporatës

Edhe pse Frashëri Law Firm, e themeluar në vitin 2004, fillimisht ishte një firmë e vogël dhe modeste, ajo gjithmonë ka qenë e përkushtuar fuqimisht ndaj përgjegjësisë sociale të korporatave, duke ndihmuar dhjetëra e më pas qindra individë falas, si dhe disa gazetarë, organizata jofitimprurëse dhe biznese të vogla pa të ardhura të mjaftueshme për të paguar një avokat për zgjidhjen e problemeve të tyre para institucioneve ose gjykatave të Shqipërisë.

Kuptimi ynë i përgjegjësisë sociale si një pjesë integrale e kulturës së avokatit dhe firmës sonë përfshin mbështetjen e ofruar për një gamë të gjerë individësh në nevojë në Tiranë, siç janë: burra, gra, familje, OJQ dhe media.

Frashëri Law Firm është gjithashtu e përkushtuar prej shumë vite dhe në çdo kohë ndaj aktiviteteve bamirëse dhe ka ofruar shërbime ligjore falas ose me zbritje për shumë individë ose subjekte.